



A.nr.2010/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtar, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.2010/2025, të datës 10.12.2025, të parashtruar nga ankuesit: XH.B, N.K dhe F.H, të cilët sipas autorizimit i përfaqëson ankuesi XH.B, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me 01.04.2026, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa më numër A.nr.2010/2025, e datës 10.12.2025, e parashtruar nga ankuesit, XH.B, N.K dhe F.H.

A r s y e t i m

Nëpunësit civil, XH.B, N.K dhe F.H (*në tekstin e mëtejme referuar: ankuesit*) më datë 10.12.2025 kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 7801/2025 të regjistruar nën shenjën A.nr.2010/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër heshtjes administrative të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndaj ankesës me numër protokolli 3285 të datës 13.10.2025.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*tutje referuar Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 22.12.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa, kjo e fundit, më datë 06.01.2026 ka dërguar përgjigjen në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e parashtruar nga ankuesit me datë 10.12.2025 është e **palejuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës rrjedh se ankuesit janë të punësuar pranë Divizionit të Inspektimit për Pylltari, në kuadër të Departamentit Qendrorë të Inspektionit për Pylltari dhe Gjueti të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, përkatësisht: ankuesi XH.B sipas Akt emërimit me numër protokoli 2773 të datës 26.08.2025 ushtron pozitën e punës **Inspektor për Shfrytëzimin e Pyjeve dhe Përpunimit të Drurit**; ankuesja F.H sipas Akt emërimit me numër protokoli 2769 të datës 26.08.2025 ushtron pozitën e punës **Inspektore për Shfrytëzimin e Pyjeve dhe Përpunimit të Drurit**, ndërsa, ankuesi N.K sipas Akt emërimit me numër protokoli 2770 të datës 26.08.2025, mbanë ushtron pozitën e punës **Inspektor për Silvikulturë Mbrojtje të Pyjeve dhe Gjueti**.

Si rrjedhojë, ankuesit me datë 13.10.2025 i janë drejtuar me ankesën me numër protokoli 3285, Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, kundër dhënies së Akt emërimit për z.B.Z të muajit gusht 2025, për pozitën e Drejtorit të Departamentit Qendrorë të Inspektionit për Pylltari dhe Gjueti në kuadër të organit përkatës të punësimit, rrjedhimisht kanë kërkuar shfuqizimin e aktit të emërimit përkatës si dhe Vendimit për transferimin me nr.ref.DP-APK-193/215 të Agjencisë Pyjore të Kosovës, rikthimin e të njëjtit në pozitën e mëparshme si Drejtor i Vendgjuetisë me rëndësi të veçantë, si dhe sigurimin që çdo lëvizje e ardhshme në pozitë, të bëhet vetëm përmes procedurës së rregullt ligjore.

Ndërsa, nga shkresat e lëndës rezulton se ankuesit nuk kanë pranuar përgjigje ndaj ankesës së tyre, ashtu që kundër heshtjes administrative të Sekretares së Përgjithshme të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, kanë parashtruar ankesë në Këshill, me pretendimet ankimore se transferimi i z. B.Z dhe Akt emërimi i fundit i lëshuar nga organi përkatës i punësimit, përbënë avancim të paligjshëm të tij në pozitë, në kundërshtim me parimet e meritës, barazisë dhe transparencës në shërbimin publik, të përcaktuar nga neni 7 dhe 8 i Ligjit për Zyrtarët Publik.

Andaj, ankuesit kërkojnë aprovimin e ankesës, me obligimin që Sekretarja e Përgjithshme dhe Udhëheqësja e Personelit e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në afat prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së Vendimit nga Këshilli, të ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për vendosjen e ligjshmërisë për rastin përkatës dhe shqyrtimin e ankesës me numër protokoli 3285 të datës 13.10.2025.

Kolegji i Këshillit lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankuesve iu referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3 ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 124 ku përcaktohet se: 1. *Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e saj juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...*”, dhe si rrjedhojë referuar*

dispozitave përkatëse ligjore Kolegji erdhi në përfundimin se me rastin e nxjerrjes së Aktit të emërimit me numër protokoll 2764 të datës 25.08.2025 si dhe Vendimit me numër Nr.ref.DP-APK-193/2015 të datës 10.03.2015, për transferimin e z. B.Z, ankuesve nuk i është cenuar ndonjë e drejtë nga marrëdhënia e tyre e punës, sepse, transferimi i përhershëm i B.Z ishte bërë në pozitën e Drejtorit të Drejtoratit Qendror të Inspekcionit për Pylltari dhe Gjueti, ndërsa akti i emërimit rezulton se i është lëshuar për pozitën e punës të kategorisë së mesme drejtuese, atë të Drejtorit të Departamentit Qendror të Inspekcionit për Pylltari dhe Gjueti, kurse faktikisht dhe ashtu siç u tha edhe më lartë, ankuesi XH.B mbanë pozitën e punës Inspektor për Shfrytëzimin e Pyjeve dhe Përpunimit të Drurit, ankuesja F.H mbanë pozitën e punës Inspektore për Shfrytëzimin e Pyjeve dhe Përpunimit të Drurit, si dhe ankuesi N.K, mbanë pozitën e punës Inspektor për Silvikulturë Mbrojtje të Pyjeve dhe Gjueti, kështu, që duke qene së ankuesit me asnjë fakt nuk kanë arritur të argumentoj pse një vendim dhe akt emërim i tillë ka cenuar të drejtat e tyre, atëherë, në kuptim të këtyre rrethanave, në vlerësimin e Kolegjit ankesa për shkak të mungesës së legjitimiteti të palës ankuese është e papranueshme, dhe për rrjedhojë, Këshilli nuk ka mundur të trajtoj në meritë ligjshmërinë e kontestuar nga ankuesit ndaj këtyre akteve.

Kështu që, për sa më sipër, Kolegji konstaton se në rrethanat e rastit konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore për pranueshmërinë e ankesës në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 ndërlidhur me nenin 125 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe se duke u mbështetur në dispozitat e nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi që të hedhë poshtë ankesën si të palejueshme, siç është përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.2010/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesve, ankuesit XH.B;
- Sekretares së Përgjithshme dhe Udhëheqëses së Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.